


#3 Gorozhup, Prizren


Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit përfshin qytetin e Prizrenit dhe **73 vendbanime tjera dhe 19,639 shtëpi. Mesatarisht, në çdo fshat janë 113 shtëpi dhe 533 banorë.** Në të gjitha fshatrat ekziston infrastrukturë rrugore, përfshirë rrugë të asfaltuara, ndriçim publik dhe trotuare. Shumica e fshatrave janë të pajisur me ndriçim publik dhe në disa fshatra janë duke u zhvilluar punimet për instalimin e ndriçimit.

Grafikoni më poshtë tregon rritjen e popullatës në Komunën e Prizrenit deri më 1991 dhe rënie të popullatës për 35% deri më 2024. Është interesante që numri i familjeve nuk ka rënë në nivel të komunës, por ka rënë në qytet (shih grafikunin më poshtë) për rreth 20%. Në qytetin e Prizrenit ka rënë popullsia për rreth 30%.




Grafikoni më poshtë tregon rënien e mesatares për ekonomi familjare (madhësi të familjes), nga një mesatare prej 8 në 4.5 në fshatra dhe 3.9 në qytet. Mbase shkaku i rënies është pjesërisht rënia demografike dhe pjesërisht fakti që tani pakkush jeton me familje të gjërë në një shtëpi.



Grafikoni më poshtë tregon rënien e ekonomisë familjare, nga një mesatare prej 8 në 4.5 në fshatra dhe 3.9 në qytet. Mbase shkaku i rënies është pjesërisht rënia demografike dhe pjesërisht fakti që tani pakkush jeton me familje të gjërë në një shtëpi.

Seria e rasteve studimore për punësim të grave në zonat rurale

Papunësia dhe arsimi i dobët i grave në zonat rurale mbeten mes sfidave më serioze socio-ekonomike në Kosovë, e cila rrjedh jo vetëm nga mungesa e vendeve të punës, por edhe nga barrierat strukturore si mungesa e transportit publik, shërbimeve parashkollore dhe mundësive për zhvillim personal. Për të adresuar këtë realitet, projekti "Vendimmarrja me dialog: Përmirësimi i jetës rurale përmes avokimit të grupeve të interesit", i zbatuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans-Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor", synon të promovojë një qasje të re në politikëbërje. Dëshmitë nga disa mini-studime që kemi relizuar synojnë të nxisin dialog dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të grave në procesin e vendimmarrjes publike. Argumenti ynë kryesor është për një bashkëpunim të qëndrueshëm mes shoqërisë civile dhe institucioneve, me qëllim krijimin e zgjidhjeve konkrete për të lehtësuar qasjen e grave në tregun e punës përmes dy intervenimeve publike: (a) hapja e sa më shumë kopshteve për të akomoduar fëmijët nga zonat rurale dhe (b) subvencionimi i transportit publik që lidh fshatrat me qytete dhe mes vete. Të gjitha dëshmitë janë se këto dy ndërhyrje do të rrisnin barazinë mes fëmijëve, do të rrisnin punësimin e grave, do të ngadalësonin shpërnguljen dhe në përgjithësi do të kishin efekt për një zhvillim më të hovshëm ekonomik në vend. Në kuadër të këtij projekti u krijua një Grup Avokues i Grave Aktiviste, i cili me mbështetje nga D4D, ka realizuar disa hulumtime në nivel të Kosovës dhe në disa fshatra të përzgjedhura për të identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në papunësinë e grave, duke vendosur kështu bazën për propozime të strukturuar dhe të adresuara politikisht.



Më poshtë paraqitet komuna si dhe fshatrat individuale për të parë që ka pak fshatra ku ka rritje të popullatës, përderisa në nivel të tërë komunës ka rënie prej 30 mijë banorëve. Përkundër përshtypjes së rritjes së qytetit në ndërtim, në qytet rënia është rreth 8,200 banorë.


Vendi	2024	2011	Dallimi	Vendi	2024	2011	Dallimi
Komunë	147,246	177,781	-30,535	Manastiricë	1,030	1,107	-77
Atmaxhë	1,300	1,685	-385	Mazrek	809	1,077	-268
Billushë	754	1,495	-741	Medvec	750	1,062	-312
Caparc	591	848	-257	Milaj	-	37	-37
Dedaj	642	619	23	Muradem	221	515	-294
Dobrushtë	319	495	-176	Mushnikovë	1,059	1,133	-74
Dojnicë	-	-	0	Nashec	1,389	1,379	10
Drajçiq	143	151	-8	Nebregoshtë	574	579	-5
Dushanovë	7,870	9,398	-1,528	Novak	19	88	-69
Gërncar	1,379	1,318	61	Novosellë	296	309	-13
Gornjasellë	305	292	13	Petrovë	878	1,194	-316
Gorozhup	290	290	0	Piranë	1,853	2,417	-564
Grazhdanik	564	884	-320	Pllanejë	631	681	-50
Gjonaj	4,061	4,818	-757	Pllanjan	1,304	1,104	200
Hoçë e Qytetit	1,480	3,410	-1,930	Poslishtë	693	1,520	-827
Jabllanicë	642	351	291	Pouskë	705	684	21
Jeshkovë	164	434	-270	Prizren	76,850	85,119	-8,269
Kabash	-	-	0	Randobravë	817	1,142	-325
Kabash i Hasit	733	882	-149	Reçan	1,066	951	115
Karashëngjergj	321	1,099	-778	Romajë	2,361	2,747	-386
Kobajë	4	-	4	Sërbicë e E.	100	179	-79
Kojushë	574	509	65	Sërbicë e P.	482	674	-192
Korishë	2,758	5,279	-2,521	Skorobishtë	909	1,128	-219
Krajk	1,469	1,676	-207	Smaç	115	375	-260
Krushë e V.	872	937	-65	Sredskë	91	69	22
Kushnin	1,751	2,110	-359	Struzhë	-	102	-102
Kushtendil	-	-	0	Shkozë	576	788	-212
Landovicë	1,151	1,149	2	Shpenadi	391	1,168	-777
Leskovec	20	134	-114	Trepetnicë	132	138	-6
Lez	2	2	0	Tupec	290	398	-108

Lubinjë e E.	1,918	1,925	-7	Velezhë	395	460	-65
Lubinjë e P.	1,632	1,227	405	Vërbiçan	12		12
Lubiqevë	602	1,602	-1,000	Vërmicë	310	661	-351
Lubizhdë	5,500	5,982	-482	Vlashnjë	1,322	1,700	-378
Lubizhdë e Hasit	2,444	2,719	-275	Zojz	534	828	-294
Lukinaj	417	558	-141	Zym	520	1,782	-1,262
Lutogllavë	617	1,218	-601	Zhivinjan	10		10
Llokvicë	468	339	129	Zhur	3,624	5,909	-2,285
Malësi e Re	371	742	-371				

Për qëllime të studimit tonë, kemi përzgjedhur fshatin Gorozhup.

Fshati Gorozhup

Gorozhupi është një fshat i komunës së Prizrenit, i vendosur në një zonë kodrinore-malorë, rreth 12 kilometra në veri-perëndim të qytetit të Prizrenit dhe fare afër kufirit me Shqipërinë. Fshati kufizohet me fshatrat Kushnin, Romajë dhe Randobravë. Pozita e tij gjeografike i mundëson lidhje të lehtë me qytetin dhe me fshatrat përreth. Sipas të dhënave të vitit 2024, Gorozhupi ka një popullsi prej rreth 290–350 banorësh, të gjithë shqiptarë. Aktualisht janë të regjistruara 59 shtëpi, të gjitha të banuara.



Gorozhup	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011	2024
Banorë	376	337	332	457	408	423	290	290
Numri i familjeve	42	39	35	38	31	34	30	48
Madhësia e familjes (mesatarja)	9.0	8.6	9.5	12.0	13.2	12.4	9.7	6.0

Banorët e fshatit kanë lidhje të ngushta ndërmjet veti dhe shpesh angazhohen në aktivitete të përbashkëta për zhvillimin e mirëqenies dhe mbështetje të ndërsjellë.

Ekonomia lokale bazohet kryesisht në bujqësi dhe blegtori. Kultivohen drithëra si misër dhe grurë, si dhe perime si domate, speca dhe patate. Blegtoria përfshin kafshë si pula, lopë dhe dele. Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë familjare, sidomos në përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

“Nuk ka punë afër fshatit. Edhe sikur të gjendej ndonjë punë në qytet, nuk kemi transport dhe nuk ia vlen me pagu transport privat.”

Arsimi: Fshati Gorozhup ka një institucion parashkollor publik ku vijnë mësimin 12 fëmijë. Rreth 25-30 fëmijë në fshat janë të moshës 0-5 vjeç dhe nuk shkojnë në kopsht.

Rreth 40-50 nxënës ndjekin mësimin fillor deri në klasën e pestë në këtë shkollë. Fëmijët ndjekin shkollimin fillor në shkollën “Vëllezërit Frashëri” deri në klasën e pestë. Për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, rreth 202-5 nxënës udhëtojnë drejt qytetit të Prizrenit apo në shkolle të tjera në fshatra përreth.

“Jemi të izoluar pa transport, sidomos gratë. Me transport do të mund të vijonim ndonjë trajnim për punë.”

Transporti dhe infrastruktura: Mungesa e transportit publik përbën një nga sfidat kryesore për banorët e fshatit, veçanërisht për gratë dhe nënat me fëmijë të vegjël. Megjithatë rrugët janë të asfaltuara dhe funksionale, mungesa e një linje të rregullt transporti e bën të vështirë qasjen në qytet. Transporti privat me kombibus është i shtrenjtë dhe jo gjithmonë i disponueshëm. Nuk ka transport publik që lidh fshatin me qytet apo

me fshatra më të mëdhenj. Transporti privat me taksì për qytet kushton 5-7 euro.

Ndriçimi publik dhe infrastruktura shitesë: Gjatë viteve të fundit, Komuna e Prizrenit ka investuar në ndriçimin publik në fshatra, por në Gorozhup, si në shumë fshatra të tjera, ende ka mungesa të konsiderueshme të ndriçimit në disa rrugë dytësore.

Gratë. Gjatë vizitës në terren, janë intervistuar disa familje për të marrë një pasqyrë më të qartë të nevojave dhe sfidave që përballen banorët e fshatit. Në fshat janë rreth 140-160 gra, prej të cilave vetëm 10-15 punojnë. Gratë e punësuar angazhohen kryesisht në arsim, shëndetësi, tregti të vogël ose projekte lokale në Prizren. Shumica e grave kontribuojnë në ekonomi familjare përmes bujqësisë dhe përpunimit të produkteve ushqimore, por pa status të rregullt punësimi.

“Po të kishte kopsht ose ndihmë për përkujdesje, ndoshta kisha mundur të kërkoj punë.”

Migrimi dhe qëndrueshmëria e popullsisë: Gjatë pesë viteve të fundit nuk është shpërngulur asnjë familje nga fshati. Banorët nuk shprehin interes për t'u shpërngulur në qytet, dhe theksojnë se po të kishte më shumë shërbime si kopsht, transport i rregullt dhe mësim gjithëditor, do të përmirësohej ndjeshëm cilësia e jetesës në fshat.

Konkluzione dhe rekomandime: Gorozhupi është një fshat me potencial të mirë zhvillimi rural, falë pozitës së tij gjeografike dhe bashkëpunimit të brendshëm të komunitetit. Megjithatë, sfida të rëndësishme si mungesa e transportit publik, e ndriçimit të plotë publik dhe mungesa e institucioneve parashkollore mbeten të pazgjidhura.

Subvencionimi i një kopshti dhe transporti publik do të këndellnin ekonomikisht, do të përfshinin gratë në treg të punës, me efekt edhe në emancipim dhe përmirësim të edukimit duke i dhënë mundësi më të mirë për karrierë dhe fëmijëve optimizëm për të ardhmen. Do të sjellte trajnimet më afër si dhe shpërngulja nuk do të shihej si mundësia e vetme për një sukses potencial në jetë.




Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit përfshin **qytetin e Prizrenit** dhe **73 vendbanime** tjera dhe **19,639 shtëpi**. Mesatarisht, në çdo fshat janë **113 shtëpi** dhe **533 banorë**.

Në të gjitha fshatrat ekziston:


- infrastrukturë rrugore (përfshirë rrugë të asfaltuara),
- ndriçim publik, dhe
- trotuare.




Fshati Gorozhup

Gorozhupi është një fshat i vendosur në një zonë kodrinore-malore, afër kufirit me Shqipërinë, me një popullsi prej **290-350 banorësh**, dhe gjithsej **59 shtëpi**.

Popullsia në fshatin Gorozhup (1948 - 2024)



Familjet në Gorozhup



Sipas banorëve, gjatë pesë viteve të fundit nuk është shpërngulur asnjë familje nga fshati.

Në fshatin Gorozhup jetojnë **rreth 140-160 gra**, prej të cilave **vetëm 10-15 punojnë**.

Gratë e punësuar angazhohen kryesisht në **arsim, shëndetësi, tregti** ose **projekte lokale** në Prizren.

"Nuk ka punë afër fshatit. Edhe sikur të gjendej ndonjë punë në qytet, nuk kemi transport dhe nuk ia vlen me pagu transport privat."

"Jemi të izoluar pa transport, sidomos gratë. Me transport do të mund të vijonim ndonjë trajnim për punë."

"Po të kishte kopsht ose ndihmë për përkujdesje, ndoshta kisha mundur të kërkoj punë."

